



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 8, datë 02/032022

**MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “ Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM nr. 458, datë 3.7.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI:**

- 1.Të miratoj , deklaratën për bashkëfinancimin e bashkisë Berat në projektin “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“, në masën 30 % të kostos totale të projektit.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

**KRYETARI I KËSHILLIT**

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

Nr. 8, datë 02/03 2022

**MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË BERAT .**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 8, 9, 54, 64, Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/217 “ Për financat e vetqeverisjes vendore”, ligjit nr.152/2013 “ Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, Ligjit 119/2014 “ Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror”, Ligjit nr.9154 datë 06.11.3003 “ Për arkivat”, Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.

**VENDOSI:**

1.Miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Berat, bashkëlidhur këtij vendimi, i përgatitur nga grupii punës të ngritur me urdhër . Nr.444 datë 16.08.2021.

2.Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit do të caktohet: Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të integritetit, vecanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit dhe të bëjë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.Të gjithë punonjësit e Bashkisë Berat informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, mbi gjendjen integritetit të bashkisë, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cënimin e integritetit të bashkisë. Punonjësit e Bashkisë duhet me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e planit të integritetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi. Së paku një herë në vit dhe më shpesh nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është i detyruar të paraqesë para Këshillit Bashkiak,një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.

3.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Ervin Ceca**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
PROJEKT-VENDIM

Nr. 10, datë 02/10/2022 / 2022

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E  
VARREZAVE PUBLIKE NË BURDULLIAS, BERAT**

Kryetari i Bashkisë mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9, pika 1.2, nenit 54, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe martjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, VKM nr. 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.712 datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e RSH-së. Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 717, datë 24.10.2019, “Për ngritjen e Komisionit për formatimit të dokumentacionit për procedurat e shpronësimit për interes publik” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë nisjen e procedurës të shpronësimit për interes publik për realizimin e projektit për zgjerimin e varrezave publike Burdullias, të pasurive private që preken nga ky projekt:

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	ZK	Konfirmuar ASHK	Sip. që shpronësohet m <sup>2</sup>
1	Agim Medi Nova	4/43	Truall	8501	PO	2600
2	Adriatik Qemal Bego Migena Haxhi Peshtani Qemal Avdyl Bego Robert Qemal Polo	4/27	Truall	8501	PO	3200
3	Feride Ibrahim Peshtanaku Migena Peshtanaku Morfata Peshtanaku	4/41	Truall	8501	PO	1800 ( nga te cilat truall 1800 m <sup>2</sup> ndertesë 67m <sup>2</sup> )

2. Shpronësimi do të financohet me fondet e Buxhetit të Bashkisë Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

Ervin Ceca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. 11 datë 02/03/2022

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA  
ZNJ. XHEMILE HAMETI**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 02.03.2022, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c; ligjit 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjit nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasen Xhemile Hameti, në shumën 40.000 (dyzetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 40.000 (dyzetë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2022.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : 25 Vota Pro, — Vota Kundër, — Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. 12 datë 02/03/2022

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA  
ZNJ. XHEMILE HAMETI**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 02. 03.2022, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social , në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjit 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjit nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasen Xhemile Hameti, në shumën 40.000 (dyzetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 40.000 (dyzetë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2022.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : 6 Vota Pro,    Vota Kundër,    Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 13, datë 02/03 2022

**MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin".

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës të 40 familjeve të pastreha që përfitojnë bonus qiraje, sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Financës.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin Ceca**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**  
Nr. 14, datë, 02/03/2022

**“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR  
NDERI PAS VDEKJES” ARJAN PUSHI**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi” Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI:**

1. Dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi pas Vdekjes’ Z, Arjan Pushi

**ME MOTIVACIONIN:**

Personalitet i shquar në fushën e mjekësisë me kontribut të vecantë akademik; shkencor kombëtar e ndërkombëtar; përkushtim profesional si mjek në shërbim të pacientëve, me humanizëm të spikatur, me impakt të drejtpërdrejtë në komunitetin e qytetit të Beratit, i jepet Doktor Arjan Pushit titulli:”Qytetar Nderi pas Vdekjes”.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin CECA**

*Elona Hoxha*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**  
Nr. 15, datë 02/07 2022

**“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “NDER I QYTETIT PAS VDEKJES” Z, JOSIF DËNA**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi” Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI:**

1. Dhënien e titullit ‘Nder i Qytetit pas Vdekjes’ Z, Josif Dëna

**ME MOTIVACIONIN:**

Për vlerat, eksperiencat, profesionalizmin dhe humanizmin e mjekut të shquar që gjysëm shekulli te jetës së tij ja përkushtoi pacientëve e kolegëve. Përkushtim i evidentuar në kontributin e tij ndaj të sëmurëve dhe nevojave të institucioneve mjekësore edhe gjatë Pandemisë Covid-19. Shembull i qytetarit model për komunitetin beratas.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin CECA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**  
Nr. 16, datë 02/03 2022

“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “NDER I QYTETIT PAS VDEKJES ” Z, GËZIM LAMAJ

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi” Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI:**

1. Dhënien e titullit ‘Nder i Qytetit pas Vdekjes’ Z, Gëzim Lamaj

ME MOTIVACIONIN:

Për përkushtim, profesionalizëm dhe humanizëm në profesionin e mjekut duke ofruar shërbim të pakursyer ndaj të sëmurëve, mbështetje për mbarë komunitetin, i papërtuar edhe në momentet më të vështira të përballjes së Pandemisë Covid-19.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Ervin CECA**

*Elana Hekua*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

**PËR SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 94 DATË 28.12.2021 “**  
**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2022 DHE PBA**  
**2022-2024 ” , ( shtesa e të ardhurës së trashëguar nga viti 2021)**

Këshilli i Bashkisë pasi u njoh me materialin “Për shtesë në vendimin e këshillit bashkiak nr. 94 datë 28.12.2021 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024 ” , mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 94 datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

**V E N D O S I :**

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 94, datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024”, të bëhen shtesa si më poshtë:

**Në pikën 1 :**

Gërma “A” shtohet : Të ardhurat gjithsej shtohen me 134,199 mijë lekë në zërin :

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2021, specifikisht:

- I. Të ardhurat lokale të trashëguara në shumën ..... 58,426 mijë lekë
- II. Transferta e pakushtëzuar e trashëguar në shumën ..... 8,270 mijë lekë
- III. Transferta sektoriale specifike e trashëguar në shumën ... 67,503 mijë lekë

Gërma “B” shtohet: Shpenzimet gjithsej shtohen me 134,199 mijë lekë

- I. Shpenzime personeli shtohen me ..... 3,000 mijë lekë
- II. Shp.operative & mirembajtje & te tjera transferta shtohen me ....79,441 mijë lekë
- III. Shpenzime kapitale shtohen me ..... 51,758 mijë lekë

#### Në pikën 4 :

Të bëhet detajimi i shtesës së buxhetit me të ardhurën e trashëguar si më poshtë :

- a) Transferta sektoriale specifike e trashëguar në shumën 67,503 mijë lekë të alokohet në programet përkatëse ku ka mbetur nga viti 2021, sipas programeve :

në 000 lekë

Tit. i Progr.	Emërtimi i Programit	Njësia Shpenzuese	Totali	Shpenzim e per Paga	Shpenzim e Operative 602	Transf.per Buxhet. Familj. dhe Individe 606	Tot Shp. Korrente (600-609)	Shpenzim e Kapitale 230+231
				600		606		
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (MZSH)	Bashkia Berat (Aparati)	<b>7,748</b>	3,000	3,748	0	<b>6,748</b>	<b>1,000</b>
3280	Mbrojtja Civile	Bashkia Berat (Aparati)	<b>3,500</b>	0	0	3,500	<b>3,500</b>	<b>0</b>
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Drejtoria e Bujqësisë	<b>4,384</b>	0	384	0	<b>384</b>	<b>4,000</b>
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	Drejtoria e Bujqësisë	<b>348</b>	0	228	0	<b>228</b>	<b>120</b>
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	<b>8,942</b>	0	8,142	0	<b>8,142</b>	<b>800</b>
9230	Arsimi parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	<b>642</b>	0	642	0	<b>642</b>	<b>0</b>
9240	Konviktet e arsimit parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	<b>37,736</b>	0	15,148	0	<b>15,148</b>	<b>22,588</b>
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	Qendra LIRA	<b>4,203</b>	0	2,155	0	<b>2,155</b>	<b>2,048</b>
<b>Totali</b>			<b>67,503</b>	<b>3,000</b>	<b>30,447</b>	<b>3,500</b>	<b>36,947</b>	<b>30,556</b>

- b) Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat lokale të trashëguara në shumën 66,696 mijë lekë të alokohet sipas tabelës më poshtë:

në 000 lekë

Titulli i Progr.	Emërtimi i Programit	Njësia Shpenzuese	Totali	Shp. Operative 602	Transfer ta 604	Tot Shp. Korrente	Shpenzi me Kapitale (230+231)
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	Bashkia Berat (Aparati)	<b>11,171</b>	5,279	864	<b>6,143</b>	<b>5,028</b>
4520	Rrjeti rrugor rural	Bashkia Berat (Aparati)	<b>7,116</b>	0	0	<b>0</b>	<b>7,116</b>
5100	Menaxhimi i mbetjeve	Bashkia Berat (Aparati)	<b>7,736</b>	5,108	0	<b>5,108</b>	<b>2,628</b>
6260	Shërbimet publike vendore	Bashkia Berat (Aparati)	<b>1,863</b>	363	0	<b>363</b>	<b>1,500</b>
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	Bashkia Berat (Aparati)	<b>4,500</b>	0	0	<b>0</b>	<b>4,500</b>
4520	Rrjeti rrugor rural	Agjencia e Sherbimeve Publike	<b>17,240</b>	17,240	0	<b>17,240</b>	<b>0</b>
6260	Shërbimet publike vendore	Agjencia e Sherbimeve	<b>6,602</b>	6,352	0	<b>6,352</b>	<b>250</b>



		Publike					
6440	Ndricimi Publik	Agjencia e Sherbimeve Publike	<b>6,504</b>	6,504	0	<b>6,504</b>	<b>0</b>
8130	Sport dhe argëtim	Q. Kulturore "M. Tutulani"	<b>640</b>	640	0	<b>640</b>	<b>0</b>
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	Q. Kulturore "M. Tutulani"	<b>2,932</b>	2,752	0	<b>2,752</b>	<b>180</b>
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	<b>100</b>	100	0	<b>100</b>	<b>0</b>
9230	Arsimi parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	<b>292</b>	292	0	<b>292</b>	<b>0</b>
<b>Total</b>			<b>66,696</b>	<b>44,630</b>	<b>864</b>	<b>45,494</b>	<b>21,202</b>

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ervin CECA**